



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:278442
Datë: 02.02.2024
Numri i dokumentit: 05276835

CA.nr.585/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetare e kolegjit, Dardan Kadolli dhe Frosina Sylejmani, anëtar të kolegjit, në çështjen juridiko-civile të Propozuesit, H. (G.) L., nga Ferizaj, me vendbanim në rruga “..” pn, Kundër propozuesve G. (M.) L. dhe B. (A.) L., nga Ferizaj, me vendbanim, në rruga “Dëshmorët e Kombit”, banesa C., Hyrja A.nr..., të cilit me autorizim, i përfaqëson Avokati Qamush Brava, nga Kaçaniku, për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me numër të lëndës 2023:278442, i datës 09.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 01.02.2024, mori këtë

A K T V E N D I M

HUDHET POSHTË si e palejuar ankesa e propozuesit të sigurimit H. (G.) L., nga Ferizaj, me vendbanim në rruga “V. E.” pn., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me numër të lëndës 2023:278442, i datës 09.01.2024.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar, me numër të lëndës 2023:278442, i datës 09.01.2024, ka vendosur: REFUZOHET, propozimi i propozuesit H. (G.) L., nga Ferizaj, i ushtruar më datën 13.12. 2023, me të cilin ka kërkuar Caktimin e masës së përkohshme, dhe ti ndalohet kundër propozuesve G. (M.) L. dhe B. (A.) L., nga Ferizaj, që të përpilojnë kontratë të

shitblerjes, për shitjen e njësisë kadastrale 01058-0, në vendin e quajtur “R. Malesia”, në sipërfaqe prej 3096m², e cila gjendet në Zonën kadastrale K., vendosjen e kësaj njësi në hipotekë në bankat të cilat veprojnë në Kosovë dhe kryerje e veprimeve ndërtimore, deri në përfundimin e procedurës gjyqësore SI I PA BAZUAR.

Kundër këtij aktvendimi, propozuesi i masës së përkohshme, në afat ligjor, ka paraqitur ankesë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim gjykatës së Apelit të të aprovet si e bazuar ankesa dhe ta ndryshoj aktvendimin e ankimuar ashtu që të aprovet propozimi për caktimin e masës së përkohshme apo të njëjtin ta prishë dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, në ankesa, si dhe analizimin dhe vlerësimin e shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa e propozuesit është e pa lejuar.

Gjykata e Apelit konstaton se propozuesi H. L. nga Ferizaj, me datë 13.12.2023, pranë gjykatës së shkallës së parë, ka parashtruar propozim për caktimin e masës së përkohshme, kundër kundërpropozuesve G. (M.) L. dhe B. (A.) L., nga Ferizaj, me vendbanim, në rruga “Dëshmorët e Kombit”, banesa C., Hyrja A.nr..., me kërkesë për caktimin e masës së përkohshme të specifikuar si në propozimin e parashtruar me shkrim.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas propozimit të propozuesit për caktimin e masës së përkohshme, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, ka marrë aktvendimin e ankimuar 2023:278442, i datës 09.01.2024, me të cilin e ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së përkohshme duke e lejuar ankesën kundër këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit duke analizuar aktvendimin e ankimuar si dhe ankesën e propozuesit, konstaton se edhe për kundër faktit që gjykata e shkallës së parë ka lejuar të drejtën e ankesës kundër aktvendimit të ankimore. Por një gjë e tillë nuk është e lejuar me dispozita ligjore përkatësisht nenin 310.5 të LPK-së, i cili parasheh që “Kundër aktvendimit mbi masën e përkohshme nuk lejohet ankimi”. Andaj, në rastin konkret gjykata e Apelit konstaton se ankesa nuk është e lejuar dhe nuk mund të lëshohet në shqyrtimin e sajë pasi që propozuesi nuk ka mundur të ushtrojë ankesë edhe për kundër lejimit nga gjykata e shkallës së parë, pasi që gjykata nuk ka autoritet që të lejojë një mjetë juridik nëse me dispozita ligjore nuk është e lejuar mjeti i tillë dhe në rastet e tilla Gjykata e Apelit është e obliguar të veproj sipas nenit 196 të LPK-së, i cili parasheh që “Ankesën e vonuar, jo të plotë, apo jo të lejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës siç parashikuar në (nenin 186)”.

Numri i lëndës: 2023:278442
Datë: 02.02.2024
Numri i dokumentit: 05276835

Nga sa u tha me sipër, Gjykata e Apelit e Kosovës, vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 310.5 lidhur me nenin 209 paragrafi 1 pika (a) e lidhur me nenin 196 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.585/2024 me datë 01.02.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari
Besnik Bisliraj, d.v